

KRYETARI I KOMUNËS
01-Nr- *MM-18729*
ME DATE 26.05.2020

SH P A L L J E P U B L I K E

Për Kontrata për punë dhe detyra specifike (Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në nenin 8, dhe nenin 10 paragrafi 6,7 dhe 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, si dhe bazuar në kerkesen e Drejtorisë për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë, me qëllim të Kryerjes së punëve në këtë Drejtori përmes; Kontratave për punë dhe detyra specifike kërkon angazhimin e 4(katër) zjarrfikës Shpetues dhe Një (1)zjarrfikës vozitës për ofrimin e shërbimeve për nevojat e kësaj Drejtorie.

**I.Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë kërkon angazhimin e
Katër (4) zjarrfikës-Shpetues**

Një (1) zjarrfikës vozitës të kategorisë”C” per nevojat e kesaj Drejtorie.

Kohëzgjatja e Kontratave do të jetë 120 ditë (4) muaj

Paga: Bruto 400 Euro për zjarrfikës Shpetues, 450 Euro për zjarrfikës vozitës

Kualifikimi: Diplomë e shkollës së mesme

Diplomë e shkollës së mesme si dhe patentshoferi i kategorisë”C”

Detyrat dhe përgjegjësitë;

- Mbeshtetes gjatë intervenimit në zjarre dhe intervenimeve tjera te ndryshme
- Kujdestaron me ekipin dhe qdo here është në gjendje gadishmerie në orar te punës dhe jashtë orarit të punës kur është nevoja.
- Punon me ndërrime dhe bartë uniformën e punës.
- Kryejnë edhe punë të tjera sipas kërkesës së eprorit

Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:

- Aftësi të mira komunikimi
- Njohuri të punës në intervenime të ndryshme dhe
- Njohuri në fushën e zjarrfikjes dhe shpëtimit

Mënyra e aplikimit:

Kandidatet e interesuar duhet të paraqesin një biografi profesionale (CV), certifikaten që ndaj tij-saj nuk janë duke u zhvilluar hetimet,kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk hyjnë në përzgjedhje nuk do të kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylles së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.



Kryetari i Komunës

Bali Muharremaj